REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 168/26 Dt. 22.04.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për formimin e Komisionit

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për formimin dhe emërimin e Komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve (ekspertëve të jashtëm), të cilët kanë aplikuar në thirrjen publike për anëtarë të komisionit për vlerësimin e projekt-propozimeve të OJQ-ve, të pranuara sipas thirrjes publike të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:

   1.1. Shykrane Berisha,..... kryesuese,
   1.2. Valmira Kasolli,..... anëtare,
   1.3. Krenar Gaxholli,..... anëtar.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit nga pika 1 e këtij Vendimi janë: të shqyrtoj dhe vlerësoj të gjitha aplikacionet të cilët kanë arritur, konform thirrjes publike për anëtarë të komisionit për vlerësimin e projekt-propozimeve të OJQ-ve të pranuara sipas thirrjes publike, si dhe në bazë të akteve ligjore dhe nënligjor që rregullojnë këtë lëmi, të bëjnë përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit përkatës.

3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 (rridhjet) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

Për:

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Të emëruarve,
- Arkivës së Kryetarit.